

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit D.R., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, PAKR.nr.184/2017 datë 19 korrik 2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 15 mars 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit D.R., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PAKR.nr.184/2017 të datës 19 korrik 2017 dhe çështja i kthehet kësaj gjykate për rigjykim.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda P.nr.61/2016 të datës 10.01.2017, i dënuari D.R., është shpallur fajtor për veprën penale ngasja në gjendje të paafte apo të dehur nga neni 379 par.4 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës KPRK-së dhe është dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 01.11.2015 deri me datë 15.04.2016. Është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 100 (njëqind) € dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, kurse përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarit dhe të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil. Kurse për veprën penale mosdhënia e ndihmës personave të lënduar në fatkeqësi të komunikacionit nga neni 328 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës KPRK-së, është liruar nga akuza.

Vendimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.184/2017 të datës 19.07.2017, ka aprovuar pjesërisht ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, por edhe sipas detyrës zyrtare, e ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.61/2016 të datës 10.01.2017, përkitazi me kualifikimin juridik të veprës penale dhe vendimit mbi dënimin, ashtu që gjeti se në veprimet e të dënuarit D.R., të përshkruara si në dispozitivin e pikës një të aktgjykimit, ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të Kodit Penal Republikës së Kosovës KPRK-së, e për të cilën veprë penale e gjykoi me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 01.11.2015 deri me datë 15.04.2016. Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit, për pjesën gjyquese është refuzuar si e pabazuar, kurse për pjesën liruese, është hudhur si e palejuar.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit D.R., av.R.G. nga P., për shkak të shkeljes së ligjit penal, por nga referati del se kundërshtohet edhe për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet dhe të dënuarit t'i shqiptohet dënim më i butë.

Mendimi i Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me parashtresën KMLP.II.nr.209/2017 e datës 09.11.2017, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit, të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e ngritura në kërkesë

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit, pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë janë të përfshirë me shkelje të ligjit penal, përkatësisht dispozitave të nenit 41 dhe 73 të KPRK-së, se përmes këtij vendimi mbi dënimin nuk do të arrihet qëllimi i dënimit e po ashtu arsyetimi i vendimit për dënimin të shqiptuar nuk përmban arsyetim ligjor, përkatësisht nuk janë arsyetuar rrethanat ligjore për matjen e dënimit të përcaktuara me dispozitën e nenit 73 të KPRK-së dhe në këtë drejtim nuk janë vlerësuar dhe arsyetuar rrethanat e sjelljes së mëparshme të të dënuarit, pranimit i fajit, meqë i njëjti ka pranuar

veprimin e kryer por jo edhe kualifikimin juridik, e po ashtu rrethanat personale dhe sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale.

Po ashtu nuk janë vlerësuar mjaftueshëm rrethanat e sjelljes së të dënuarit gjatë zhvillimit të procedurës penale, kërkim falja e tij për familjen e të dëmtuarit dhe premtimi i tij se nuk do të përsëris vepra të kësaj natyre e këto rrethana nëse do të aplikoheshin do të ishin baza të mjaftueshme për të konstatuar se edhe me dënim më të butë do të arrihet qëllimi i dënimit siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në pajtim me dispozitën e nenit 435 par. 1 dhe 436 par. 1 të KPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa gjeti se:

kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar

Aktgjykimi i shkallës së dytë, bazuar në referatin e paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.12 të KPPK-së, meqë nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 370 par.8 të KPPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, me rastin e vendimit për llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar vetëm një rrethanë rënduese dhe atë dëmtimin e vlerës së mbrojtur gjegjësisht se në rastin konkret ka humbur jetën një person. Në arsyetim është theksuar “...dëmtimin e vlerës së mbrojtur e që është jeta e njeriut, ku si pasojë e këtij aksidenti tragjikisht para kohe u nda nga jeta i riu tani i ndjeri Milot Bajrami...”. Ashtu që me këtë rrethanë, gjykata e shkallës së dytë ka marrë si rrethanë rënduese elementin qenësor të veprës penale rrezikimi i trafikut publik dhe në këtë mënyrë arsyet për faktin vendimtar –lartësinë e dënimit janë të paqarta.

Duke vepruar kështu, aktgjykimi i shkallës së dytë, përmban shkelje të dispozitës së procedurës penale nga neni 384 pa.1 nënpar.12 të KPPK-së e me këtë aktgjykimin e bën juridikisht të paqëndrueshëm.

Në rigjykim gjykata e shkallës së dytë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe të marr një vendim të drejt dhe të ligjshëm në këtë çështje penale

juridike, ashtu që me rastin e vendimit për llojin dhe lartësinë e dënimit të jep arsye të qarta për rrethanat nga neni 74 të KPRK-së dhe të evitohet shkeljen në fjalë.

Nga këto arsye, kjo gjykatë konform nenit 438 par. 1 pika 1.2 të KPPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml. nr. 310/2017, më 15 mars 2018

Procesmbajtësi,

Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,

Valdete Daka